

TË RINJTË PËR TURIZMIN E AVENTURËS

Qendra Youth Act, në mbështetje nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), u angazhua në zbatimin e projektit “Të rinjtë për turizmin e aventurës”, financuar nga programet e BE-së i cili filloi më datë 11 Prill 2022 dhe mbaron më 10 Dhjetor 2022. Projekti synoi të identifikojë destinacionet turistike të bashkisë Kukës duke promovuar turizmin e aventurës si një trend për të rinjtë dhe jo vetëm. Guida Turistike, e vetmja për Bashkinë Kukës, Virtual Tour, eksplorimi në terren dhe faqet zyrtare të EYCA ishin disa nga elementët kryesorë të cilët luajtën një rol të rëndësishëm në promovim. Të gjitha aktivitetet dhe sipërmarrjet e lidhura me to ishin në interes të Bashkisë Kukës, të publikut dhe të vetë të rinjve të përfshirë.

CLUSTER NETWORK

Aktorë biznesi, Grupe Interesi,
Individë

HIKING NË TERREN

Turizëm Natyror
Turizëm Kulturor
Turizëm Aventure
Turizëm Historik

GUIDA TURISTIKE

Promovim i Turizmit
në Bashkinë Kukës

EYCA NETWORK

Rrjeti më i madh i kartëmbajtësve
në Europë
(eyca.org)

VIRTUAL TOUR

QENDRA YOUTH ACT - është një organizatë jofitimprurëse (OJQ), me seli në Tiranë - Shqipëri, e themeluar dhe e regjistruar ligjërisht në korrik 2013, në të cilën synon të fuqizojë të rinjtë nga mosha 14 deri në 30 vjeç për të marrë një rol aktiv në jetën e tyre, familjen dhe shoqërinë. Vizioni i Qendrës është fuqizimi i rinisë si “motori” i zhvillimit të vendit dhe misioni është të mbështesë pesë I-të: Nisma Rinore, Integrimi i të Rinjve, Përfshirja e të Rinjve, Frymëzimi Rinor dhe Ndërlidhja Rinore. Qendra udhëhiqet nga të rinjtë për të rinjtë.

Youth Act ofron një qendër për të mbështetur individë, organizata dhe iniciativa që fokusohen në punësimin e të rinjve në Shqipëri. Youth Act udhëhiqet nga kreativiteti, prosperiteti, sipërmarrja dhe integriteti dhe fokusohet në shtatë fusha kryesore: Kulturë, Art dhe Sport; Qytetari dhe Demokracia; Arsimi dhe trajnimi; Karriera dhe Punësimi; Globalizimi; Inovacioni, Mjedis dhe Multimedia.

Youth Act është anëtare e Agjencisë Evropiane të Informacionit dhe Këshillimit për Rininë, e themeluar në vitin 1986, me seli në Luksemburg. EYCA u themelua në vitin 1987 me qendër në Bruksel, duke përfaqësuar një rrjet prej 41 organizatash degësh në 38 vende evropiane, me mbi 6 milionë mbajtës të rinj karte dhe 60,000 kompani zbritjeje. Roli i EYCA është të nxisë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve dhe shërbimeve të informacionit për të rinjtë.

Aktivitetet e Youth Act bazohen në 3 shtylla kryesore: Projektet Rinore, Shërbimet e Vullnetarizmit dhe Shpërndarja Evropiane e Kartave Rinore.

EYCA NETWORK - RRJETI MË I MADH I KARTËMBAJTËSVE NË EVROPË (eyca.org)

100 të rinj të pajisur me Kartën Rinore Evropiane pjesë e grupit më të madh të kartëmbajtësve rinorë me përfitime njësoj si bashkëmoshatarët e tyre në 36 vena të Evropës si vijon:

- Mundësi kursimi ! - Oferta nga shumë biznese në Shqipëri dhe Europë.
- Aktivizim & pjesëmarrje. - Bëhen pjesë e një komuniteti rinor aktiv dhe pjesëmarrës në shoqëri.
- Status të njëjtë me studentët & të rinjtë në Europë. - Përfitime nga të njëjtat oferta, zbritje dhe informacion.
- Mundësi punësimi dhe Intershipi. - Këshillim karriere dhe hapsira për intership në institucione të ndryshme.
- Mundësi Aktivizimi dhe Promovimi i Talenteve tek të Rinjtë - Hapësirë promovimi dhe mbështetje.

CLUSTER NETWORK - AKTORË BIZNËSI, GRUPE INTERESI, INDIVIDË

25 biznese dhe bashkëpunëtorë të tjerë të inkurajuar e nxitur në:

- Zhvillimin e aftësive kreative lidhur me marketingun dhe promovimin e biznesit.
- Rritjen e rrjetëzimit mes grupeve të ndryshme të interesit për të promovuar më gjerë turizmin në Kukës dhe zhvillimin ekonomik në tërësi.

HIKING NË TERREN

TURIZËM AVENTURE-TURIZËM NATYROR-TURIZËM KULTUROR-TURIZËM HISTORIK

Kukës - Shishtavec - Mështekna e Shishtavecit - Guri i Mëngjesit - Guri i Shqipës - Kanioni i Vanave - Dushkaja e Novosejt.

Kukës - Fshati Fshat - Mulliri i vjetër - Ura e fshatit - Xhamia - Kroi i Bardhë - Bjeshka e Terfojes.

Kukës - Fshati Fshat - Shpella - Ujëvara - Fshati Cajë (Bjeshkët e Cajës)

45 të rinj të përfshirë në këtë paketë aktivitete, janë kthyer në pionierë të:

- Promovimit turistik përmes Kartës Rinore Evropiane;
- Eksplorimit natyror e historik;
- Aktivizimit të vazhdueshëm për mirëqenie dhe shëndet;

GUIDA TURISTIKE - PROMOVIM I TURIZMIT NË BASHKINË KUKËS

Një material, i vetmi për Bashkinë Kukës, i cili promovon trashëgiminë kulturore, natyrore, historike, kulinare e etnografike përmes fakteve, informacioneve e fotove ilustruese. Këto potenciale janë elementët kryesorë të cilët do të duhet t'ë promovohen më tej e të zgjerojnë numrin e turistëve që vizitojnë qytetin e Kukësit dhe rrethiant përreth.

VIRTUAL TOUR

Kjo videoje promovuese me pamje filmime të destinacioneve turistike, me titra e sugjerime, përmes publikimit dhe shpërndarjes në rrjetet sociale po vihet në dispozicion të gjithkujt, turistëve vendas e të huaj, anëtarëve të kartës rinore në Shqipëri dhe Evropë, si dhe çdo institucioni apo aktori të mundshëm për të marrë informacione të nevojshme paraprake e për t'i eksploruar ato në realitet. Do të shërbejë si një model promovimi edhe për destinacione të tjera, jo vetëm të Bashkisë Kukës.

www.kukes.gov.al

www.youthact.al

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës Youth Act dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Financuar nga
Bashkimi Evropian

#ReLOaD

Programi Rajonal mbi Demokracinë
Vendore në Ballkanin Perëndimor

